

## **Raport individual për rezultatet e konsultimeve publike për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.**

### **1. Titulli i draft aktit**

Projektvendim i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”.

### **2. Kohëzgjatja e konsultimeve**

*Konsultimi në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike u realizua në përputhje me përcaktimet në nenin 15 të ligjit “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”.*

*Konsultimi elektronik për projektvendimin e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj”, u zhvillua në datat 10.03.2023-11.04.2023. Po ashtu janë zhvilluar takimet konsultative me grupet e interesit në muajt prill-maj 2023.*

### **3. Metoda e konsultimit**

*Metodat e përdorura për konsultimin publik:*

- 1. Konsultimi në faqen zyrtare të konsultimit publik, RENJK;*
- 2. Tryeza të konsultimit me ekspertë dhe grupet e interesit<sup>1</sup>.*

*Kontributet janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së draftstrategjisë, nga grupet e interesit dhe ekspertë të fushës së kërkimit shkencor dhe shkresa zyrtare, si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara kryesisht pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat janë mbledhur nga grupi i punës i ngritur në MAS për hartimin e draftstrategjisë.*

---

<sup>1</sup> Përfaqësues të biznesit, Konferenca e Rektorëve, ministrinë dhe institucionet që angazhohen në kërkim shkencor.

#### **4. Palët e interesit të përfshira**

Procesi i hartimit të projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj” ka nisur me urdhrin nr. 53, datë 9.02.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit “Për ngritjen e grupit koordinues për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit”.

Gjithashtu në zbatim të urdhrin nr. 336, datë 15.06.2022, të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për krijimin e grupeve teknike të punës për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor 2023 – 2030”, janë ngritur grupet teknike të punës, të cilat kanë përfaqësues nga MAS dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Gjithashtu i është dërguar shkresë të gjithë institucioneve, fusha e veprimit të të cilëve përfshin dhe kërkimin shkencor, për të na përcjellë përfaqësuesit e tyre në Grupin Ndërinstitucional të punës. Procesi i hartimit të strategjisë është mbështetur nga dy ekspertë të ofruar nga programi EU4Innovation.

Hartimi i dokumentit strategjik ka qenë një proces gjithëpërfshirës, i cili që në faza të hershme të hartimit të tij ka përfshirë të gjithë institucionet fusha e veprimit të të cilëve përfshin dhe kërkimin shkencor.

Procesi i konsultimit publik u realizua me rreth 90 aktorë, në të cilët bënin pjesë: ministrinë e linjës, konferenca e rektorëve (institucionet e arsimit të lartë publike dhe jopublike), Akademia e Shkencave, Qendra Ndërinstitucionale Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH), Agjencia për mbështetjen e shoqërisë civile (AMSHC), Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndhmës (SASPAC), Instituti i statistikave, Dhoma e tregtisë dhe Industrisë, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI), Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Po ashtu, u zhvilluan takime konsultative me përfaqësues të biznesit, sindikatat dhe OJF të fushës, konkretisht Qendra për arsim cilësor, Dhoma e Tregtisë Tiranë, Organizata Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. (në total 6 përfaqësues).

Më poshtë, gjeni një përmbledhje të takimeve konsultative që janë zhvilluar nga muaji mars 2023 deri në maj 2023, të cilat janë të pasqyruara edhe në tabelën e konsultimit që i bashkëlidhet praktikës së projektvendimit.

Në kuadër të hartimit të Strategjisë Kombëtare të Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2023-2030 u zhvillua në datë 29.03.2023 takimi i parë konsultues me rektorët e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe jopublik.

Në datën 18.04.2023 është zhvilluar takimi me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera të përfshira, si Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale (DPPI), Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AADF) mbi konsultimin e draft strategjisë së kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë 2023-2030.

Në datë 19.04.2023 u zhvillua konsultimi i draft strategjisë me biznesin, si përfaqësues të biznesit, sindikatat dhe OJF të fushës, konkretisht nga Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile, Qendra për Arsim cilësor, Dhoma e Tregtisë Tiranë, Organizata Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. (në total 6 përfaqësues)

### **5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara**

*Kontributet janë përcjellë në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së draftstrategjisë, nga grupet e interesit dhe ekspertë të fushës së kërkimit shkencor dhe shkresa zyrtare, si dhe në tryezat e konsultimit të zhvilluara kryesisht pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, të cilat janë mbledhur nga grupi i punës i ngritur në MAS për hartimin e draftstrategjisë.*

*Përgjithësisht ka pasur sugjerime mbi buxhetin dhe kostimin e aktiviteteve në strategji sipas institucioneve të përfshira. Në total ka pasur 19 sugjerime nga të cilat 3 janë pranuar pjesërisht, 14 janë pranuar tërësisht dhe dy janë refuzuar.*

Çështja e adresuar <i>(p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
Financimi i kërkimit shkencor	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ të zhvilluar në datë 29.03.2023 me rektorët e institucioneve të arsimit të lartë publik dhe jopublik, u bënë	Institucionet e arsimit të lartë (56 përfaqësues të IAL-ve)	Pranuar pjesërisht	Në takim u sqarua se synohet të rritet angazhimi që për pjesën e buxhetit të shtetit dhe shifra që parashikohet 4,5 mld lekë pra 0.14 % në vitin 2030 të PBB.

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>pyetje lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm si dhe me financimin e kërkimit shkencor, ku u tha se tentohet në 1% të PBB e ndarë nga buxheti i arsimit në tërësi dhe kjo konsiderohet një shifër e vlerësueshme, por ajo që ngjall diskutim është që kur flasim për 1 % të PBB ne flasim për fianancim nga Buxheti i Shtetit, flitet çfarë buxheti ofron pastaj sa ofrojnë institucionet e arsimit të lartë apo partnerët e tjerë që kanë interes në kërkimin shkencor apo në përlllogaritjet e pjesëmarrjeve tonë projektet ndërkombëtare kjo nuk ka të bëjë pastaj me financimin që buxheti ka për kërkimin shkencor. Domethënë këto janë të ardhura të tjera të cilat</p>			<p>Vlerësojmë se nuk duhet ta shikojmë të ndarë buxhetin e qeverisë apo kërkimin shkencor në institucionet publike me buxhetin për kërkimin shkencor në institucione të tjera apo në biznesin privat, sepse qeveria natyrisht që ndikon me politika, me kuadrin ligjor me incentiva të ndryshme. Pra në të vërtetë mund të themi që përtej buxhetit të qeverisë mund të bëhet kërkim shkencor por qeveria ka përgjegjësinë që ta stimulojë ta mbështesë ta nxisë kërkimin shkencor që zhvillohet edhe në institucionet e tjera. Për shembull mund të japim si shembull si buxheti që vihet në dispozicion për projekte të përbashkëta me biznesin, pra ne kemi një buxhet për të nxitur bashkëpunimin e IAL-ve me biznesin. Bizneset do të</p>

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>realizohen dhe këto janë të mundshme edhe sot që flasim për secilin IAL apo institucion kërkimor që të gjejë burimet nga arsimit të aplikojë për to dhe të rrisi si të thuash financat e brendshme në tërësi edhe të ndihmojë vetveten në rezultatet që ka vendosur si planifikim të vetin. Kurse kur flasim për % të mbështetjes atëherë % e mbështetjes është e qeverisë dhe nuk mund të jetë një kompozim i diversifikimit të mundësive të buxhetimit të kërkimit shkencor. Është e rëndësishme që të themi që sot jemi në një fazë që eksplorojmë, jemi në një fazë rritje, jemi në një fazë ku është rritur interesi i institucioneve të arsimit të lartë në fushën e kërkimit shkencor, jemi në një</p>			<p>bashkë financojnë projekte të tilla, pra ky është një stimul dhe prandaj është përfshirë tek shifra 1 % dhe është marrë si angazhim, si përgjegjësi që rritja e kërkimit shkencor që rritja e buxhetit për kërkimin shkencor të mos përfshijë vetëm buxhetin e shtetit, por me politikën me stimujt me incentivat me projekte të përbashkëta të zhvillohet dhe kërkimi shkencor. Kjo strategji prandaj është gjithëpërfshirëse që të gjitha institucionet të angazhohen. Nëpërmjet strategjisë synohet të marrin angazhimin të gjithë institucionet bashkë. Kur themi ta çojmë këtë indikator në 1% të GDP-së bëhet fjalë për një indikator që quhet GERD dhe që mat pikërisht këtë gjë se sa buxhet vihet në dispozicion nga shoqëria</p>

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>fazë ku bashkëpunohet mes institucioneve dhe institucioneve kërkimore dhe që kemi kaluar atë foshnjërinë e futjes në një proces i cili është në interes jo vetëm të arsimit por edhe të zhvillimit të shoqërisë kështu që nëse ne deri dje flisnim për vlera të cilat nuk kishin ndonjë rëndësi specifike ne sot jo vetëm që kemi kaq angazhime sa kemi aktualisht ne flasim me një mënyrë të ndryshme nga disa vite më parë dhe që në përballje me partnerët tanë dhe në angazhimin që ne kemi me ta dhe në kuadrin e projekteve edhe në kuadrin e financimit që secili institucion që futet në projekt si pjesë e financimit të përgjithshëm të projektit, them që financimi i</p>			<p>shqiptare në funksion të kërkimit shkencor, jo vetëm nga buxheti i shtetit por dhe buxheti i të gjithë aktorëve që kontribuojnë në kërkim shkencor dhe jo vetëm kaq por edhe atyre fondeve që vijnë nga projektet ndërkombëtare. Ajo që ne nuk kemi në këto momente është një baseline pra ku jemi ne tani, pasi akoma nuk e dimë shumë mirë se ku jemi për shkak të mungesave në informacion dhe në statistika. Nëse deri në fund të vitit INSTAT-i do të ketë disa të dhëna me të cilat mund të vendosen dhe disa objektiva më realiste edhe më largpamës.</p>

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>kërkimit shkencor duhet të ashtu sikur thotë dhe plani startegjik duhet të jetë një element shumë i rëndësishëm i zhvillimeve të IAL-ve institucioneve kërkimore sepse ajo që themi shpesh kontributi i arsimit të lartë në zhvillimin e shoqërisë duhet të jetë ai kontribut që kanë institucionet e tjera.</p>			
<p>Nxitja dhe formimi i menaxherëve të projekteve të IAL-ve në kuadër të ndërkombëtarizimit dhe projekteve për të përfituar fonde nga jashtë</p>	<p>Duhet të gjejmë disa piketa që në një mënyrë ose në një tjetër të jetë e zbatueshme dhe të përfitojmë dhe t'i bëjmë gjërat siç duhet sepse mund të themi ta çojë 1 % ose 2 ose 3 por në fund të fundit e dimë mirë që nuk do të dalim tek 1 % sepse i gjithë Arsimi i lartë e ka 2,6 % nga buxheti i shtetit, atëherë kemi mundësinë të marrim fonde në bashkimin europian dhe ti</p>	<p>Institucionet e Arsimit të Lartë</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Ky propozim nuk u mor në konsideratë plotësisht pasi nuk lidhet me detyrimet e MAS. IAL-të kanë autonomi financiare dhe të burimeve njerëzore. MAS ka bërë pjesë të strategjisë objektivi n specifik zhvillimi i kapaciteteve njerëzore i infrastrukturës së kërkimit shkencor dhe një nga rezultatet që pritet të arrihet është forcimi i kapaciteteve të kërkuesve shkencor në lidhje me aplikim në</p>

Çështja e adresuar <i>(p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	implementojmë këtu këto projekte dhe do na shërbejë për të mësuar se si shkruhen projektet e kërkimit shkencor projekte serioze.			programet kuadër dhe ndërkohë ne kemi ndërmarë disa nisma si për të hapur programe studimi por edhe kurse që do ti dedikohen shkrimit të projekteve.
Përfshirja e biznesit në strategji	Gjatë zhvillimit të takimit konsultativ në datë 19.04.2023 me biznesin u vlerësua nga pjesëmarrësit se kjo strategji del përtej MAS, pasi nëse flasim për kërkim shkencor, teknologji dhe inovacion, që do të thotë edhe për pjesën e buxhetit, ministria për sipërmarrjen duhet të jetë aktore shumë e rëndësishme sepse po merret me inovacionin edhe pse nuk e ka fushë përgjegjësie drejtpërsëdrejti. Kur flasim për përmirësimin e bashkëpunimit në nivel kombëtar, duhet të gjejmë një model bashkëpunimi në	Përfaqësues të biznesit, sindikatat dhe OJF të fushës, konkretisht nga Agjencia për Mbrojtjen e Shoqërisë Civile, Qendra për arsim cilësor, Dhoma e Tregtisë Tiranë, Organizata Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë. (në total 6 përfaqësues)	Pranuar pjesërisht	Sugjerimet përfshihen në kuadër të hartimit të ligjit për shkencën, i cili është në proces hartimi. Të gjitha këto sinjalizime janë patur parasysh edhe në përgatitjen e materialeve për kapitullin 25, kjo është hera e parë që bëjmë bashkë gjithë aktorët, duke qenë se kjo është një politikë transversale, pasi këto fusha nuk kanë vetëm një ministri përgjegjëse, por janë pjesë e shumë ministrive. Propozimet e përcjella janë jashtë fushës së përgjegjësisë shtetërore të MAS dhe do të referohen me institucionet përkatëse në hartimin



<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>kërkimin shkencor. Aktualisht nuk kemi një model bashkëpunim në kërkimin shkencor për sa i përket sipërmarrjes (biznesit). Ne kemi nevojë për incentivë. Kush është një incentivë që shpenzimet për kërkimin shkencor të zbriten. Këto shpenzime nuk më njihen. Pse duhet të paguaj taksa për të zhvilluar ekonominë, duke qenë se po krijoj ekonomi edhe për një IAL, qendër apo entitet tjetër.</p> <p>Së dyti, qendrat e kërkimit shkencor duhet të jenë të disa tipeve (private, shtetërore apo një bashkëpunim midis privatit/ biznesit dhe shtetit. Duhet të vendosen disa parashikime në strategji që</p>			<p>dhe konsultimin e projektligjit për shkencën.</p>

Çështja e adresuar <i>(p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	kërkuesit shkencor mos ti mbajmë taksa. E kemi shumë të nevojshme ta incetivojmë kërkimin shkencor për 10 vite. Pra, strategjia duhet të jetë e guximshme, që të adresojë incentiva që në fillim. Ajo që nuk pashë tek strategjia ishin masa konkrete përsa i përket biznesit, që biznesi ta shohë me sy të lirë.			
Roli i teknologjisë dhe kërkimit shkencor	Sugjerohet të riformulohet një paragraf në faqen 59 Aktualisht në arsimin parauniversitar janë pjesë e kurrikulave edhe lëndët e teknologjisë që i pajisin nxënësit me informacionet bazë të domosdoshme. Megjithatë, sidomos pas periudhës së vështirë të kaluar gjatë mbylljes së detyruar prej COVID 19, doli	Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit (AADF)	Pranuar	

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>domosdoshmëri zgjerimi i njohurive që marrin nxënësit. Kjo bëri që qeveria të marrë një sërë masash. Kështu që në vitin shkollor 2022-2023, në bashkëpunim me AADF, në Shqipëri ka nisur pilotimi i projektit "Inteligjenca Artificiale për të rinjtë" (Intel® AI for Youth). Që nga viti 2023, ky program zbatohet në më shumë se 27 vende në mbarë botën. Teknologjitë në zhvillim si AI po ndryshojnë dhe po riformojnë botën duke pasur ndikim të jashtëzakonshëm në sektorin e punësimit dhe të ekonomisë, ndaj dhe ky projekt ka për qëllim të rrisë aftësitë që lidhen me teknologjinë dhe inteligjencën artificiale tek nxënësit shqiptare, të moshës</p>			

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>nga 13 deri 19 vjeç. Të rinjtë do mund të mësojnë nëpërmjet një kurrikule të ndërtuar nga Intel® Corporation, lider në industrinë e prodhimit të gjysmëpërçuesve, e cila është një ndër kompanitë më të mëdha të teknologjisë në botë. Janë bërë pjesë e projektit 9 institucione publike të arsimit të mesëm të lartë në të cilët kurrikula e IA zhvillohet si orë jashtë kurrikulare dhe janë krijuar 2 kurse private falas për të rinjtë. Janë bërë pjesë e projektit 160 nxënës dhe trajnuar 25 mësues.</p>			

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
<p>Sugjerime mbi përfshirjen ASHSH si institucion kontribuues apo përgjegjës</p>	<p>- Në pikat 1.1.1 dhe 1.1.2, gjerësisht miratimi i ligjit për shkencën në Republikën e Shqipërisë dhe miratimi i paketës së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të ri për shkencën në Republikën e Shqipërisë të shtohet ASHSH si institucion bashkëhartues; ( të shtohet si institucion pjesëmarrës tek masat. )</p> <p>- Në pikën 1.1.4 duhet të shtohet ASHSH si institucion pjesëmarrës, duke qenë se objektivi i ajs do të jetë e përfaqësuar në strukturën koordinuese kombëtare për politikën mbi shkencën, teknologjinë dhe inovacionin;</p>	<p>Akademia Shkencave</p>	<p>Pranuar</p> <p>Pranuar</p>	



<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>dhe te përgjegjësive të saj e si një institucion i përfaqësuar ne bordet e AKKSHI-t;</p> <p>-Ne pikën 1.1.8 ASHSH të shtohet si institucion pjesëmarrës, për rishikimin e akteve ligjore në kuadër të kapitullit 25 të BE "Shkenca e kërkimi shkencor";</p> <p>-Në lidhje me pikën 1.1.12 Hartimi i udhëzuesit për hartimin e planit për hendeqet gjinore në institucionet kërkimore-shkencore (përfshirë IAL-të) vlerësojmë se kostimi është më i lartë se nevojat;</p> <p>- Në lidhje me pikën 1.2.4 shprehemi se duhet të jetë me renditje parësore, si pikë e</p>		<p>Pranuar</p> <p>Pranuar</p> <p>Pranuar</p>	

Çështja e adresuar <i>(p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	<p>synimeve kryesore, duke e kaluar si çështje te pare te objektivit specifik nr. 2. gjithashtu kërkohet që ASHSH te shtohet si institucion pjesëmarrës, sepse sipas Ligjit nr. 59/2019 është e drejte e saj të krijojë njësi dhe qendra kombëtare shkencore qe integrojnë studiues dhe burime kërkimore ne nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe aktualisht është ne procesin e krijimit te një amze-baze të kërkuesve shqiptare ne bote dhe te rrjetëzimit te tyre;</p> <p>-Në lidhje me pikat 1.2.7 e 1.2.8, krijimi i rrjeteve te kërkuesve shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë dhe krijimi e përditësimi periodik i databazës</p>		Pranuar	



<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>se kërkuesve shkencore ASHSH shtohet si institucion pjesëmarrës sepse pranë saj administrohen dhe funksionojnë gjithnjë ne pasurim dy baza te dhënash: ECRISS.AL (për informacionin që ka të beje me kërkuesit shkencore në Shqipëri) dhe COBISS.AL (per shërbimin bibliografik dhe katalogues shkencor në shkalle vendi). Kjo eshte e vlefshme edhe per 1.3.2 (hartimi dhe publikimi i te dhënave per kërkimin shkencor sipas periodicitetit te përcaktuar ne programin e statistikave zyrtare 2022-2030), duke qene se ASHSH është burim parësor i këtyre te dhënave. Kjo per arse sepse pranë saj gjendet qendra kombëtare e digjitalizimit</p>			

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>bibliografik te informacionit shkencor, sipas marrëveshjes me institucionin qe ka ne pronësi e administrim programin e sipërpërmendur, IZUM, me qendër ne Maribor (Slloveni), që veron nën kujdesin e UNESCO-s;</p> <p>- Në objektivin specifik nr. 3 (përmirësimi i mbledhjes, përpunimit, interpretimit he publikimit të treguesve statistikore dhe te tjerë te kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit) te shtohet ASHSH si institucion pjesëmarrës sepse pranë saj funksionojnë dy bazat me te rëndësishme të informacionit shkencor në vend, COBISS.AL dhe ECRIS.AL, si dhe institute</p>		<p>Refuzuar</p>	<p>Nuk është pranuar sugjerimi për tu përfshirë në masën e interpretimit dhe publikimit të treguesve statistikore dhe te tjerë te kërkimit, zhvillimit të teknologjisë dhe inovacionit), pasi është në fushën e kompetencës së INSTAT.</p>

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>të specializuar, që kane ne përgjegjësi të tyre edhe vlerësimin e programeve në arsimin parauniversitar: Instituti Kombëtar i Fizikes he Instituti Kombëtar i Matematikës; -Në pikën 1.3.5 (hartimi i treguesve te performancës mbi kërkimin shkencor me qëllim krahasues ne nivel European dhe ndërkombëtar) kërkohet përcaktimi i qartë i objektivit në kostim, duke iu referuar detyrimeve që Qeveria ka marre përsipër si anëtare dhe aktore e Procesit te Berlinit, ne te cilin rrjeti i akademive te shkencave te rajonit jane subjekt nominal;  -Në objektivin specifik nr. 2.1 të shtohen shprehimisht institutet kërkimore si subjekt</p>		<p>Pranuar</p>	

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>bashkëpunimi dhe ASHSH te shtohet si institucion pjesëmarrës e ndërveprues. Institutet kërkimore te shtohen ne te njëjtin cilësim edhe ne pikën 2.2.2, fuqizimi i kapaciteteve te IAL-ve për transferimin ndërkombëtar te teknologjisë;</p> <p>-Në pikën 2.2.5 ASHSH shtohet si institucion pjesëmarrës për hartimin e udhëzuesve që përfshijnë edhe protokollet e procedurat për hartimin e projekteve te përbashkëta;</p> <p>-Në objektivin specifik nr. 3 (reformimi i kurrikulës se shkencës ne arsimin parauniversitar duke përfshirë STEM ne edukim) ASHSH</p>		<p>Pranuar</p> <p>Pranuar</p>	<p>Nuk janë pranuar sugjerimet që lidhen me objektivin 3 pasi ato i</p>

Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi
	shtohet për te njëjtat arsye si në nr. 9 këtu.		Refuzuar	përkasin arsimin parauniversitar dhe fushës së shkencës.
Kostimi	Sugjerohet që fondi i planifikuar nga RASH të bëhet 10,560,000.00 lekë. Viti 2023-2030.	Qendra Ndërinstitucionale Rrjeti Akademik Shqiptar RASH	Pranuar	
Kostimi	DPPI përcjell sugjerime mbi kostimin e masave dhe objektivave ku ajo është e përfshirë. Kodi sipas objektivit ku DPPI është përgjegjëse 2.2.1 Deri në 2025 Vlera 8.170.560.00 lekë Kodi sipas objektivit ku DPPI është përgjegjëse 2.2/2.3 Çdo vit.	Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Intelektuale (DPPI)	Pranuar	

<p>Çështja e adresuar (p.sh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</p>	<p>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</p>	<p>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
	<p>Vlera 3.407.760.00 lekë Kodi sipas objektivit ku DPPI është përgjegjëse 2.4 Çdo vit. Vlera 3.566.880.00 lekë Kodi sipas objektivit ku DPPI është përgjegjëse 2.4.1. Çdo vit. Vlera 761.500.00 lekë Kodi sipas objektivit ku DPPI është përgjegjëse 3.2.1. Çdo vit. Vlera 275.000.00 lekë\</p>			